

STATUTI I SHOQËRISË
DHE
AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SPE CONSTRUCTION” SH. P. K

Në bazë të ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” të ndryshuar, ne të nënshkruarit shpallim si më poshtë:

NENI 1
FORMIMI I SHOQËRISË

Formohet shoqëria e quajtur “SPE CONSTRUCTION” SH.P.K (që më poshtë do të quhet " Shoqëria") me ortakë:

1. Shoqëria “MS CONSTRUCTION” SH.P.K, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar, me seli në adresën Njësia Bashkiake Nr. 8, Rruga “Qemal Stafa”, pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, përballë Qendrës Lincoln, Tiranë, regjistruar pranë Regjistrit Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me numrin unik identifikimi NUIS - M11923006V, përfaqësuar nga Z. Sokol Metoja, në cilësinë e administratorit, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me letërnjoftimin ID me nr.personal I20618075A .
2. Shoqëria “RS CONSTRUCTION & ENGINEERING” SH.P.K, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar, me seli në adresën Rruga “Ismail Qemali”, Ap.22, Nr. Pasurie 2/827+1-22, Zona Kadastrale 8270, Vol.81, Fq 234, Tiranë, regjistruar pranë Regjistrit Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me numrin unik identifikimi NUIS - M11609022Q, përfaqësuar nga Z. Roland Sinjari në cilësinë e administratorit, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me letërnjoftimin ID me nr.personal I41108079R.



1

3. **Vasil Ndreçka**, i lindur më 18.07.1984, në Tiranë, me banim në Rruga e Durrsit, Nd.7, H.39, Ap.6, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar me letënjoftimin ID me nr.personal I40718073M .
4. **Glon Bakalli**, i lindur me 10.08.1977, në Tiranë, me banim në Rruga Alla, Nd.3, H.12, Ap.13, Farkë, Selitë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar me letënjoftimin ID me nr.personal H70810052B .
5. **Albi Sërbo**, i lindur me 23.04.1983, në Tiranë, me banim në Rruga Besim Imami, P.50, Shk.1, Ap.9, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar me letënjoftimin ID me nr.personal I30423119Q .

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria "SPE CONSTRUCTION" SH.P.K, e ka qendren e selise ne Rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballe Qendres Lincoln. Njesia Bashkiake nr.8, Tirane.

NENI 3

KOHËZGJATJA


Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin ekonomik të saj, për një periudhë kohe të pakufizuar, e cila fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i Veprimtarisë së shoqërisë është:

Ndërtime të ndryshme kulturore, turistike, shtetërore, shëndetësore, bujqësore, fabrika, uzina, banesa, komplekse banimi, hotelerie etj. Projekttime, instalime, punime restaurimi etj. Veprimtari në fushën e transportit, të mallrave brenda dhe jashtë vendit, me mallrat të vetë shoqërisë dhe të të tretëve. Import-eksport në përgjithësi brenda dhe jashtë vendit. Import-eksport mobilje, veshje MBF, mobilim sallash konferencash, parket, moket. Ndriçim, import-eksport, ndriçim tavanesh. Veprimtari në fushën e ekspertizës lidhur me ndikimin ne mjedis dhe auditimin mjedisor, veprimtaritë e lidhura me mbrojtjen kundër zjarrit dhe auditimit të energjisë.Grumbullim dhe transportim të mbetjeve inerte. Ndërtim ujësjellësa, kuz, mbrojtje lumore, diga, etj.Aplikim dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i të gjitha Lejeve, Licencave, Autorizimeve dhe Miratimeve paraprake/perfundimtare, te cilat mundësojnë ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë si dielli, era, uji, etj, si dhe i veprave të tyre ndihmëse, dhe zhvillimin e këtyre aktiviteteve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e



Shqipërisë; Implementimi, menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë si dielli, era, uji, etj, si dhe i veprave të tyre ndihmëse, si dhe shfrytëzimi operimi dhe mirëmbajtja e tyre; Importi dhe eksporti i mallrave e paisjeve të teknologjive të ndryshme në fushën e energjisë elektrike, që përdoren për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve/sistemeve/impjanteve fotovoltaike, eolike, hidrike (përfshirë panelet diellore, turbinat e erës, inverterat, transformatorët, linjat e transmetimit/shpërndarjes, dhe gjithë aksesorët/pajisjet e tjera të konvertimit, transmetimit, sinjalizimit, monitorimit, mbrojtjes, transmetimit të të dhënave), etj; Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve për të cilat është krijuar, i cili nuk ndalohet me ligj.

Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga ortakët e saj.

Shoqëria mund të zgjerojë ose të kufizojë fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë.

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë dhe është i ndarë në 5 (pesë) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues, shoqëria "MS CONSTRUCTION" SH.P.K, e cila zotëron 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues, shoqëria "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" SH.P.K, e cila zotëron 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues, Vasil Ndreçka, i cili zotëron 15% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues, Glon Bakalli, i cili zotëron 15% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues, Albi Sërbo, i cili zotëron 10 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të ortakëve.

Ortakët përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.



3

NENI 6

TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

Kapitali themeltar ose pjesë të veçanta të tij, janë të transferueshme nga ortaku tek të tretët. Transferimi i kapitalit apo pjesëve të tij nga Ortaku në favor të tretëve, kryhet gjithnjë me akt noterial të posaçëm.

Shoqëria mund të rrisi kapitalin themeltar ose mund ta zvogëlojë atë, por gjithnjë jo nën kufirin e 100,000 (një qindmijë) lekë. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të ortakëve të shoqërisë dhe sipas parashikimeve të ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare".

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

NENI 7


TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotat përkatëse të pjesëmarrjes pa miratimin paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë.

Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më



të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet me parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë. Në një rast të tillë ortakut që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me leter rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje. Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortakut që transferon atë, do të ndahet midis ortakëve pranues, në të njejtën masë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ata zotërojnë, përveç rasti kur ka një marrëveshje të kundërt.

Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen te treset plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve me shumicë të thjeshtë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjet në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

NENI 8

ORGANI VENDIMMARRËS

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortakët, vendosin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

5

- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- g) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

Të gjitha vendimet e marra nga Ortaket e shoqërisë duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- ç) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

NENI 9

ADMINISTRATORI



Administrator i shoqërisë emërohet **Z. Sokol Metoja** me letëmjoftimin ID me nr.personal I20618075A. Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje bazuar në nenin 95/1 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 10

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vetë.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara ortakëve themelues të shoqërisë në mbledhjen e asamblesë së ortakëve.
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve.

NENI 11 VITI FINANCIAR

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.


NENI 12 BILANCI I SHOQËRISË DHE DIVIDENTËT

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përbërë nga Ortakët, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori, si dhe vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

NENI 13 MBARIMI I SHOQËRISË

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Ortakëve ;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) Me vendim të gjykatës;



NENI 14
TRANSFORMIMI I SHOQËRISË

Transformimi i shoqërisë bëhet me vendim të Ortakëve ose kur ekzistojnë faktorë të jashtëm detyrues ligjore, në këto raste vendimi merret pasi është paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë nga ana e administratorit. Çdo transformim i bërë në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm.

NENI 15
BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dalë në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.

NENI 16
MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.



8

NENI 17
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky statut është hartuar me vullnetin e lirë dhe të plotë të Ortakëve të shoqërisë dhe është nënshkruar prej tyre.

Ky Statut u redaktua në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe.

ORTAKËT E SHOQËRISË
“SPE CONSTRUCTION” SH.P.K

Shoqëria “MS CONSTRUCTION” SH.P.K

Administrator

Sokol Metroja

Sokol Metroja



Shoqëria “RS CONSTRUCTION & ENGINEERING” SH.P.K

Administrator

Roland Sinjari

Roland Sinjari



Vasil Ndreçka

Vasil Ndreçka

Glon Bakalli

Glon Bakalli

Albi Sërbo

Albi Sërbo

Tiranë, më 01.11.2023